


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Janar, 2022

**Tiranë, më 17 Shkurt 2022:** Në Janar 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 35 mld lekë, duke u rritur me 47,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 9,7 %, në krahasim me Dhjetor 2021. Importet e mallrave arritën vlerën 55 mld lekë, duke u rritur me 21,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe ulur me 37,4 %, në krahasim me Dhjetor 2021. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 20 mld lekë, duke u ulur me 7,7 %, krahasuar me Janar 2021 dhe me 64,2 %, në krahasim me Dhjetor 2021.


Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Janar 2022, në rritjen e eksporteve prej 35,0 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +24,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +9,8 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +3,2 pikë përqindje.


Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Janar 2022



**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Janar 2022, në rritjen e importeve prej 21,1 %, krahasuar me Janar 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +7,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,0 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +4,3 pikë përqindje. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,4 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Janar 2022



**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Janar 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Janar 2021 janë: Itali (38,0 %), Gjermani (3,4 herë) dhe Kosovë (103,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Spanjë (67,3 %), SHBA (5,7 %) dhe Turqi (35,2 %).

Në muajin Janar 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Janar 2021 janë: Itali (21,5 %), Turqi (59,3 %) dhe Greqi (4,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kinë (6,8 %), Zvicër (54,7 %) Rusi (23,0 %) dhe Kosovë (3,5 %) .

**Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Janar 2022**



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,9 %, të gjithë tregtisë. Në Janar 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 53,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Itali (33,3 %), Turqi (8,2 %), Gjermani (7,8 %) dhe Greqi (6,5 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Janar 2021

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Janar 2021**

	Eksporte		Importe	
	Janar 2021	Janar 2022	Janar 2021	Janar 2022
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>19.238</b>	<b>26.501</b>	<b>24.556</b>	<b>29.221</b>
Austri	131	295	394	462
Gjermani	1.087	3.724	3.128	3.298
Greqi	1.119	1.844	3.809	3.969
Itali	11.902	16.425	11.118	13.509
Spanjë	2.415	790	476	661
Kroaci	290	306	277	341
Të tjera të BE-së	2.294	3.117	5.353	6.980
Mbretëri e Bashkuar	49	106	263	374
Kinë	704	739	4.888	4.555
Kosovë	1.344	2.740	539	520
Maqedonia e Veriut	413	1.445	555	602
Rusi	0	2	698	537
SHBA	467	440	771	792
Turqi	575	373	4.383	6.982
Ukrainë	20	24	153	929
Zvicër	21	113	1.490	675
Të tjera	906	2.524	7.125	9.828
<b>Gjithsej</b>	<b>23.736</b>	<b>35.006</b>	<b>45.420</b>	<b>55.015</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Janar 2022**

Grup-mallrat	Eksporte		Importe	
	Janar 2021	Janar 2022	Janar 2021	Janar 2022
<b>Gjithsej</b>	<b>23.736</b>	<b>35.006</b>	<b>45.420</b>	<b>55.015</b>
Ushqime, pije, duhan	2.596	3.333	7.126	9.084
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.574	9.367	5.963	8.217
Produkte kimike dhe plastike	621	1.280	6.004	6.139
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	143	207	701	1.049
Prodhime druri dhe letre	618	868	1.457	2.340
Tekstile dhe këpucë	9.299	10.059	5.883	6.507
Materiale ndërtimi dhe metale	4.250	6.569	6.056	9.595
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.009	2.590	10.534	10.332
Të tjera	626	733	1.696	1.751

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Janar 2022**

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
<b>Gjithsej</b>	<b>11.902</b>	<b>16.425</b>	<b>1.344</b>	<b>2.740</b>	<b>1.087</b>	<b>3.724</b>	<b>1.119</b>	<b>1.844</b>
Ushqim, pije duhan	823	965	235	273	129	162	304	324
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	169	2.196	186	966	165	2.441	38	443
Produkte kimike dhe plastike	177	303	125	337	2	3	53	64
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	130	191	0	1	4	0	1	3
Prodhime druri dhe letre	399	546	55	54	22	17	74	143
Tekstile dhe këpucë	7.400	7.783	12	6	543	686	482	452
Materiale ndërtimi dhe metale	1.477	2.692	528	916	35	251	132	369
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	959	1.333	134	116	172	142	9	9
Të tjera	368	417	69	71	16	23	26	38

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Janar 2022**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
<b>Gjithsej</b>	<b>11.118</b>	<b>13.509</b>	<b>4.383</b>	<b>6.982</b>	<b>4.888</b>	<b>4.555</b>	<b>3.809</b>	<b>3.969</b>
Ushqim, pije duhan	1.387	1.704	407	393	88	114	996	1.173
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	763	1.366	83	185	0	0	883	720
Produkte kimike dhe plastike	1.485	1.323	393	697	574	448	457	410
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	588	865	21	28	29	49	3	2
Prodhime druri dhe letre	320	435	225	384	98	84	212	290
Tekstile dhe këpucë	2.706	3.251	1.248	1.171	801	791	255	265
Materiale ndërtimi dhe metale	1.314	1.850	1.185	3.262	514	433	704	793
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	2.292	2.346	607	647	2.314	2.229	171	217
Të tjera	263	370	214	215	469	406	128	99

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri